



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 210, Datë 17.08.2022

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 168, DATË
28.06.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SALILLARI ENERGY TRADE”
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458/1 prot., datë 11.08.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.06.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike” dhe “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 168, datë 28.06.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 168, datë 28.06.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar. Shoqëria kishte detyrimin që të informonte ERE-n çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në përfundim të këtij procesi.
- ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 168/2022 me shkresën nr. 469/8 prot., datë 30.06.2022.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 469/9 prot., datë 01.08.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, brenda afatit të përcaktuar..
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet

organit, që e ka në kompetencë të nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 168, datë 28.06.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI